

---

**RECENSIONE**

---

**BEQIR META: MINORITETET DHE NDËRTIMI KOMBËTAR NË SHQIPËRI (1912 – 1924), Shtëpia Botuese “KRISTALINA-KH”, Tiranë, 2013, 716 f.**

Monografia “Minoritetet në Shqipëri” e prof. dr. Beqir Metës është një studim i thelluar, që i ka marrë autori dhjetë vjet punë këmbëngulëse. Me një strukturë të menduar mirë, ai rreket ta trajtojë këtë temë shumë të rëndësishme e me vlera aktuale, në të gjitha rrafshet. Organizuar me të gjithë elementët që kërkon një monografi shkencore (që nga parathënia deri te treguesi i emrave të vendeve dhe të njerëzve) monografia e z. Beqir Meta e trajton problemin së pari teorikisht e më tej, hap pas hapi, edhe historikisht, duke koordinuar kronologjinë me problematikën. Autori ndalet fillimisht në konceptet rreth minoriteteve dhe vështirësive për përcaktimin e nocionit “minoritet”. Pas kësaj, përmes një vështrimi retrospektiv, ai pozon prehistorinë e minoriteteve në viset shqiptare deri në vitin 1912. Me këtë rast, duke operuar me të dhëna të shumta por të pasigurta statistikore, na paraqet njëherësh si vështirësinë për të fiksuar shifra të sakta të padiskutueshme, ashtu edhe tablo shumë afër realitetit, të nxjerrë përmes krahasimeve e arsytimeve të qëndrueshme. Paraqitja e të dhënave për të kaluarën e minoriteteve të pranishme në viset shqiptare, ndriçon origjinën dhe situatën e tyre të dikurshme në trevat shqiptare. Duke trajtuar në këtë prehistori qindravjeçare, minoritetin grekofon, të krijuar jo vetëm nga grekë, dhe atë vllleh, të mbetur sot si një komunitet etno-kulturor, z. Meta rrëzon ose mbështet teza të llojllojshme, një pjesë e të cilave vijnë, për motive politike e nacionaliste, të konsumohen abuzivisht deri në ditët tona.

Në monografi trajtohet historia e minoriteteve në Shqipëri nga viti 1913 deri në përfundim të Luftës Parë Botërore. Paraprakisht autori me një krahasim domethënës, jep të dhëna për politikat e dhunshme të fqinjëve ndaj “pakicave shqiptare” kryesisht në vitet 1913-1914. Në vijim, duke trajtuar, përmes një vështrimi ndërdisiplinor minoritetin grekofon në vitet 1913-1920, jepet një material shumë interesant dhe me vlerë për arritjen e konkluzioneve. Autori argumenton faktorët e

instrumentalizimit të minoritetit grek e grekofon, duke dhënë me këtë rast qëndrimin dashamirës e pa shovinizëm të qeverive shqiptare më pas. Në monografi ndër të tjera një vend i veçantë i është dhënë edhe debatit shqiptaro-grek në Konferencën e Paqes në Paris mbi natyrën, përbërjen dhe madhësinë e minoritetit grekofon. Autori argumenton e rrëzon teza të ndryshme, të cilat ndeshen deri në ditët tona, duke ndriçuar me vërtetësi problemet në fjalë. Në këtë rast, jepen gjithashtu fakte e paraqiten opinione edhe për minoritetin bullgar ose maqedon, si edhe për arumunët. Për periudhën 1912-1920 autori faktin dhe analizon edhe qëndrimin e këtyre minoriteteve apo pakicave në përgjithësi ndaj shtetit të ri shqiptar dhe ndaj politikës së tij kombëtare, por edhe të individëve, apo grupeve, brenda kuadrit të këtyre komuniteteve.

Përpjekjet e shtetit shqiptar për konsolidimin e identitetit dhe institucioneve kombëtare në vitet 1920-1924 dhe qasja e tij ndaj problemit të minoriteteve trajtohen nga prof. Meta në një kapitull të veçantë (IV).

Mbi një dokumentacion autentik, të paraqitur nga autori, del qartë përfundimi se shteti shqiptar pavarësisht nga vështirësitë e shumta në vitet e para të formatimit të tij u kushtoi vëmendjen e duhur dhe trajtimin konform legjislacionit ndërkombëtar për minoritetet pakicave brenda tij, duke u bërë në këtë drejtim shembulli më pozitiv në Ballkan. Autori argumenton bindshëm pse veprimi i kështu Tirana zyrtare, si dhe evidenton të gjitha hapat e saj për të harmonizuar politikën shtetërore ndaj minoriteteve me synimin madhor, konsolidimin dhe hapat në drejtim të demokratizimit.

Përmes raporteve në Lidhjen e Kombeve (LK) për çështjen e minoriteteve në Shqipëri konfirmohet se shteti i ri kishte hyrë, që në hapat e para, në rrugën që ndjek sot bota e qytetëruar, me synimin për t'i kthyer minoritetet në ura lidhëse midis shteteve e kombeve. Përpjekjet e Tiranës zyrtare për trajtimin me reciprocitet të çështjeve të ngjashme me fqinjët, sjellin të dhëna të reja interesante për dinjitetin e figurave të ndryshme politike të periudhës, dhe përgjithësisht elitës politike shqiptare. Është meritë e autorit, që ka argumentuar, mbi dokumentacionin e nevojshëm, se politikën shtetërore në fushën e arsimit dhe institucioneve fetare ishin fusha të rëndësishme në të cilat u veprua me sukses në mbrojtje të interesave kombëtare e shtetërore, njëherazi me respektimin e standardeve më të mira të kohës, për trajtimin e minoriteteve nacionale dhe pakicave etno-kulturore.

Faktet konkrete të ballafaqimit me politikat shoviniste greke për vise të ndryshme të Shqipërisë së Jugut, deri në Himarë etj., tregojnë se Tiranës zyrtare për gati një shekull i është dashur të përballojë presione, mungesa reciprociteti për të njëjtën çështje dhe përsëri ka qenë konstruktive në politikën ndaj minoriteteve.

Kreu V, përveç vlerës historike, paraqet interes edhe për aktualitetin e problematikës. Kontrasti në qëndrimin ndaj minoriteteve të shtetit shqiptar, krahasuar me qëndrimin e fqinjëve, pak ka ndryshuar gjatë periudhës gati njëshekullore që pasoi vitin 1912. Duke analizuar qëndrimin e Greqisë ndaj minoriteteve të saj, posaçërisht ndaj shqiptarëve, duke shkelur në dëm të tyre edhe traktate e norma ndërkombëtare, të cilat ishte angazhuar të respektonte, autori fakton përpjekjet e mëdha që iu desh të bënte Tiranës zyrtare për të minimizuar keqtrajtimin e shqiptarëve në Çamëri e vise të tjera, dhe spastrimin etnik të tyre përmes deportimit të dhunshëm. Përmes faktologjisë së zgjedhur autori na jep një tablo të arrirë të situatës.

Vëmendje të veçantë autori i kushton edhe trajtimit të problemit të minoriteteve në arenën ndërkombëtare. Ndër të tjera, mbi bazë korrespondence e raportesh autentike, autori ndërton pozicionin dhe qëndrimet e organizmave ndërkombëtarë ndaj problemit të minoriteteve në Shqipëri.

Përveç objektivitetit në trajtimin e problemit, dokumentet nxjerrin në pah edhe qëndrime subjektive ndonjëherë të ndikuara nga politikat zyrtare të shteteve fqinje, veçanërisht të Greqisë. Natyrisht LK nuk ishte një instrument i përsosur dhe pësia e ndryshme e shteteve pjesëmarrëse pasqyrohej edhe në qëndrimet e saj për probleme të caktuara. Megjithatë, Shqipëria arriti të mbronte me dinjitet të drejtat e veta si shtet sovran dhe të argumentonte bindshëm se ndiqte një politikë të standardeve më të mira të kohës për minoritetet, padyshim katërcipërisht më të mirë se politika e fqinjëve të saj tokësorë, që i kishin hyrë me të gjitha mjetet rrugës së pastrimit etnik të viseve shqiptare të aneksuara. Raporti i Komisionit Hetimor të LK dërguar në Shqipëri në vitin 1923, nën drejtimin e finlandezit Sederholm, konfirmoi botërisht nacionalitetin dhe politikën e drejtë të Tiranës zyrtare për minoritetet duke hedhur poshtë gjithashtu tezat greke për përfshirjen e gjithë ortodoksëve të Shqipërisë së Jugut brenda minoritetit grek, i cili u verifikua edhe një herë se ishte katër herë më i vogël se sa pretendonte Athina.

Dokumentet e përdorura në monografi nxjerrin në pah se pavarësisht propagandës së madhe të Greqisë dhe veprimeve destruktive e antishkencore të agjunkturës së saj në Shqipëri, LK u informua për situatën reale, për përmasat numerike dhe gjendjen apo trajtimin e minoriteteve në Shqipëri.

Kreun e shtatë prof. Meta ia kushton minoritetit grek e grekofon në Shqipëri në vitet 1920-1924.

Materiali i paraqitur në këtë rast është sa i freskët e pak i njohur, ose përceptazi i njohur, aq edhe interesant. Duke diferencuar grekofonët nga grekët, autori me kompetencë bën dallimin e dy komuniteteve, por dhe evidenton të përbashkëtat e tyre.

Duke neglizhuar qëllimisht diferencat midis grekëve etnikë dhe të tjerëve, madje duke quajtur të tillë gjithë ndjekësit e besimit ortodoks në Shqipëri, Athina zyrtare vepronte për konsum të brendshëm dhe për përshtjellimin e opinionit publik ndërkombëtar e të kancelarive të Fuqive të Mëdha. Njëherësh ajo nxiste minoritetin dhe grekomanët në Shqipëri, të bombardonin me kërkesa për shkolla qeverinë shqiptare, duke bërë zhurmë vetë pranë organizmave ndërkombëtarë, ndërkohë që ndiqte tjetër politikë ndaj minoritetit shqiptar në Greqi.

Autori jep shumë të dhëna për respektimin e të drejtave të minoriteteve nga shteti shqiptar. Ai edhe pse me mjete të kufizuara del se financoi për arsimimin e minoritetit grek në gjuhën e vet, shuma të konsiderueshme, shpesh në përmasa më të mëdha, krahasuar me financimet për arsimim të shumicës së popullsisë.

Politikat konstruktive e të lavdërueshme të Ministrisë së Arsimit në fillim të viteve 20, dalin qartë në monografi. Kështu u përballuan precedentet e krijuara nga shkollat private greke, të vështirësive për gjetjen e mësuesve të aftë për të mësuar gjuhën shqipe nxënësve të shkollave minoritare, shmangien e pretendimeve absurde të grekofonëve për të mos i shkolluar fëmijët në shkolla bashkë me fëmijët shqiptarë, eliminimin e propagandës së hapur nacionaliste greke në shkollat e minoritetit etj.

Prof. Meta jep një informacion të bollshëm me këtë rast, edhe për qëndrimet e minoriteteve, të cilat shpesh ishin në një linjë politike (për fat të keq) me pozicionet e shteteve nga identifikonin origjinën dhe lidhjet. Në këtë kuadër në fillim të viteve 20, bie në sy qëndrimi aspak pozitiv i një pjese të minoritetit grek, që instruktohej nga Athina, duke i

sjellë vështirësi Shqipërisë në rrugën e konsolidimit, por edhe duke tendosur në një farë mënyre artificialisht raportet ndëretnike.

Një trajtim të veçantë, me interes, ka realizuar autori edhe lidhur me qëndrimin e shtypit dhe inteligjencies shqiptare për problemin e grekofonëve në vitet 1920-1924. Gjithashtu me vlerë janë edhe paraqitja e debatit shqiptaro-grek për minoritetin, i cili shkoi deri në forumet ndërkombëtare (tentativat e Athinës për rigjallërimin e një lëvizjeje “vorio-epirote”). Pas trajtimit të hollësishëm të problemeve që lidhen me minoritetin grekofon autori trajton edhe minoritetet dhe pakicat e tjera në Shqipëri.

Në sythe të veçanta evidentohet me kompetencë qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj vllahëve, malazezëve dhe bullgarëve.

Në përfundim, do të shtoja se monografia e prof. Metës vlerësohet një nga arritjet më të suksesshme të tij në punën shkencore dhe një vlerë e shtuar për albanologjinë shqiptare.

**Marenglen VERLI**



---

**DOKUMENTE E MATERIALE**

---

**TESTAMENT I PRIFTIT PJETËR LEPORE  
NGA DRISHTI**

Familja fisnike Lepore është njëra nga më të dokumentuarat ndër fisnikët (*nobiles*) e Drishtit mesjetar.<sup>1</sup> Nga kjo familje shfaqet nëpër dokumente edhe një pjesëtar tjetër i saj, ky ishte Pjetër Lepore nga Drishti, i biri i Nikollë Zogit (*Petrus Lepore, filius Nicholay Zoch de Drivasto*). Pjetër Lepore, i cili ishte presbiter dhe shërbyes kishtar (kustod) në Kishën e Shën Mërisë së Madhe të Raguzës (*ecclesia S. Marie Maioris de Ragusio*) paraqitet nëpër tre dokumente: në njërin më datë 24 janar 1399, në një tjetër më 3 ose 4 gusht të vitit 1402,<sup>2</sup> dhe në një testament të vetin që Pjetër Lepore e bën më 17 mars 1404 në Raguzë.

Testamentin e tij që deri më sot nuk është publikuar akoma në gjuhën shqipe, po e jap të përkthyer të plotë në vazhdim. Ky testament ka rëndësi historike, pasi aty përmenden kishat kryesore të Drishtit dhe persona të ndryshëm banues në atë qytet, që ishin të afërmit e këtij kleriku. Përveç kësaj, testamenti na transmeton stilin dhe formën juridike që përdorej në Mesjetë për tekste të tilla, si dhe pjesëmarrësit që ishin prezent në përpilimin e tyre:

**Testament i priftit Pjetër Lepore nga Drishti**

Viti 1404, indikacioni XII, dita e 17-të e marsit (17 mars 1404), në Raguzë, para fisnikut dhe të maturit zotit rektor, ser Marino de Bodacia, rektor i nderuar i qytetit dhe i komunës së Raguzës, dhe para gjyqtarëve të qytetit të lartpërmendur zotit Johane de Volcio dhe zotit Simone Nona, Ne, Basili prift nga Tivari prifti Dominikus dhe prifti Inkus shërbëtor i kishës, që jemi dëshmitarë nënshkrues në këtë testament duke u betuar për fjalën e vërtetë me

---

<sup>1</sup> Në lidhje me të dhëna të zgjeruara rreth familjes shih: Edmond Malaj, "Familje fisnike të Drishtit Mesjetar", në: *Studime Historike* 3-4, Tiranë: 2014 (Viti LXVII (L), f. 23-50.

<sup>2</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 745, ref. 2; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1400-1405)*, vëll. I, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë 1987, nr. 240.

duar të vendosura mbi njëra tjetrën dëshmojmë që dom Pjetër Lepore i biri i Nikollë Zogut të Drishtit, bëri testamentin e vet duke qenë vetë me mendje dhe kujtesë të shëndoshë. Përmbajtja e këtij testamenti është e tillë:

Në emër të Krishtit, Amen! Në vitin 1404, Unë dom Pjetër Lepore (Piero Lepore) i biri i Nikollë Zogut, po bëj testamentin tim të fundit me trup dhe mendje të shëndoshë e me vullnet të mirë. Së pari i lë Shën Mërisë së Madhe për të dhjetët dhe si shumë të parë 1 perper.

Pastaj një prifti që duhet të shkojë në Jerusalem për shpirtin tim, i lë 110 perperë. Pastaj i lë atij 100 perperë, sepse me to duhet t'u shpërndajë rroba disa të varfërve, për shpirtin tim. Pastaj i lë kishës së Shën Mërisë së Drishtit pesë dukatë ari, me qëllim që të blihet një çarçaf. Pastaj i lë kishës së Shën Gjergjit të Drishtit pesë dukatë, për blerjen e një çarçafi. Pastaj i lë 30 perperë mbesës time Gjina. Pastaj edhe për mezonen dhe mandiqët (mandixi), për të cilat i dhashë hua burrit të mbesës sime Gjon Dobramisit 32 perperë, caktoj që nëse mbesa ime dhe nipat e mi falimentojnë, dua që ato para ti jepen kishave të Shën Mërisë dhe të Shën Gjergjit të Drishtit për nder të altarit. Pastaj i lë frat Margarisit nga Bosnja, diurnalin tim\* (libër lutjesh ditore) të lutjeve. Pastaj lë breviarin tim që të shitet së bashku me gjërat e mia, në ndërgjegjen epitropëve të mi (garantuesve). Pastaj po i lë vëllazërisë në paradhënie 10 perperë. Pastaj i lë dom Pjetër Sanit njërin nga tapetët e mi (tapidi). Pastaj i lë ipeshkvit De Markana, atit tim shpirtëror një dukat. Pastaj u lë epitropëve (garantuesve) të mi nga një dukat për secilin që të bëjnë një garanci të mirë për veprimet e mia, dhe ashtu si të jenë korrekt me mua, ashtu Zoti ua shpërbleftë shpirttrave të tyre. Pastaj i lë Domincit të birit të Dobroslavit një perper për një meshë. Pastaj nga sendet e mia që do të shiten, dua tu lë fretërve të Bosnjës 15 perperë, dhe ajo që tepron të përdoret për 30 këndime psalmesh. Pastaj, nëse tepron ndonjë gjë, dua që tu jepet epitropëve (garantuesve) të mi për të çuar meshë dhe për psalme, sipas dëshirës së tyre. Pastaj i lë Pjetrit të ... 1 dukat. Pastaj dua që të jenë epitropët e mi dom Matio Pozolo i Ulqinit, pastaj dom Marku nga Ipolati, pastaj Mark de Thani nga Ulqini, me tej dom Zivani Bosiamilost, ata që do të kenë përgjegjësinë, që e gjithë kjo të jetë zbatuar, me qëllim që askush nuk mund të prishë këtë testament. Këtë testament nuk mund ta hedh poshtë askush.<sup>3</sup>

\* *Diurnale* = libër lutjesh ditore.

<sup>3</sup> "1402, 17 martii, Ragusii. *Testamentum presbyteri Petri Lepore Drivastensis. MCCCCIII, indicatione XII, die XVII mensis marcii, Ragusii coram nobili et prudente domino rectore res Marinode Bodacia, honorable rectore ser Marino De Bodacia, honorabile rectore ciuitatis et comunis Ragusii et iudicibus dicte ciuitatis Ser Johane de Volcio et Simone de Bona, nos Basilius presbyter de Antibarò et presbyter Dominichus et presbyter Inachus sacrista, testes subscripti in dicto testamento et iurati in verbo veritatis vnus in manibus alterius et alter alterius, testificamur, quod dompnus Petrus Lepore Filius Nicholay Zoch de Driuasto suum condidit testamentum, existente ipso in sua bona mente et memoria, cuius tenor talis est: In Christi nomine amen Anno MCCCCIII. Io don Piero Lepore figlio de Nichola*

Në këtë testament në radhë të parë bie në sy shuma që ky prift u lë kishave katedrale Shën Mërisë dhe Shën Gjergjit të Drishtit (nga pesë dukatë ari), që është relativisht më e madhe se çdo shumë tjetër e lënë, qoftë kishës së Shën Mërisë së Madhe të Raguzës, qoftë personave të tjerë, duke presupozuar që presbiteri dom Pjetër Lepore duhet të ketë qenë kanonik i kapitullit të njërës prej këtyre dy kishave.

Së dyti bie në sy lidhja që Pjetri mbante me familjen, pra me mbesën dhe nipat që mesa duket jetonin akoma në Drisht, duke i kujtuar në testament. Kjo dëshmon që lidhjet familjare në Drishtin mesjetar ishin të vlerësuara dhe mbaheshin gjallë vazhdimisht, duke u kujdesur për to edhe pas vdekjes me anë të testeve. Ngatërrues është këtu emri i Nikollë Zogit (*Nichola Zoch*) që ishte babai i Pjetrit, duke e vënë në pikëpyetje origjinën familjare të Pjetër Lepores, nëse i përkiste familjes Lepore apo familjes Zogi. Megjithatë duke e iu përmbajtur mbiemrit të tij e rendita atë në këtë punim tek historia e familjes Lepore.

**Edmond MALAJ**

---

*Zoch faço lo mio vltimo Testamento, infermo del corpo e sano dela mente mia cum bona voluntade. Inprima lasso a Sancta Maria Mazore per decma et primicia perpero uno. Item lasso a vno prete, che debia andare a Jerusalem per l'anima mia perperi cento diexi. Iem lasso perperi cento, che si debia vestire alquanti poueri per anima mia. Item lasso a sancta Maria di Driuasto ducati cinque de oro, che si debia conparare unë sauano, item lasso a sancto Georgy di Driuasto ducati cinque per uno sauano. Item lasso perperi trenta ala mia neza Gina. Item la menzone e li mandixi, per li quali io inprestay al marido dela mia neza Gon Dobrimize(?) perperi trenta dui, et se mia neza et li mey neputi falisse, voglo che se dia a sancta Maria et an sancto Gorgy de Driuasto per honore del altaro. Item lasso a fra Malgarize, frate de Bosna, lo mio diurnale. Item lasso lomio breuiario che se venda com li altri cose mie a incanto in consciencia deli mey epitropi. Item lasso ala fratiglia deli preuedi diexe. Item lasso a don Piero San uno de li mei tapidi. Item lasso al uescouo de Marchsana mio padre spirituale ducato vno. Item lasso agli mey epitropi per zaschuno ducato vno, che illi façano bona massaria deli mei facti, cosy dio per lor anima como farano per la mia. Item lasso a Dominze figlolo de Dobroslauo perpero uno per una messa. Item de le cose, che se vendera, voglo che se daga ali frati di Bosna perperi quindexe, se auançera qualche cosa, pre trenta saltri. Item se ancora auançara, voglo che daga li mei epitropi per messe et per salterii doue li pare a loro. Item lasso a don Piero de ... ducato uno. Item voglo che sia mey epitropi don Mathio Pizolo de Dulcigno, item don Marcho de Ippolato, item Marcho de Thanni da Ulcigno, item don Zivani Bosiamilost, quello che loro sarano in consciencia che sia facto, et che neguno non possa rompere questo testamento. Hoc autem testamentum nullo testimonio rumpi possit. Testamenta Notarie 1402-1414, fol. 57-58<sup>v</sup>. AAlb. II, nr. 745.*



